




**BULETINI I GRUPIT**

**H  N A**



- Ky publikim është financuar nga Qeveria Suedeze me mbështetje të Save the Children. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi i saj. Qeveria Suedeze apo Save the Children jo domosdoshmërisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.



 Autor: **HANDIKOS**

 Zyra Qendrore: Rr. Dardania 4/7 D2 Prishtinë

 [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org)

 [www.handi-kos.org](http://www.handi-kos.org)

## PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1: HYRJE .....	06
Qëllimi i buletinit .....	06
KAPITULLI 2: RRETH GRUPIT “HËNA” .....	09
KAPITULLI 3: MISIONI DHE VIZIONI I GRUPIT “HËNA” .....	11
KAPITULLI 4: ANGAZHIMI I GRUPIT “HËNA” .....	13
KAPITULLI 5: OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË GRUPIT “HËNA” .....	15
KAPITULLI 6: AKTIVITETET E ORGANIZUARA ME GRUPIN “HËNA” .....	17
AVOKIMI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE .....	21



## QËLLIMI I BULETINIT

- Qëllimi i këtij buletini është të fuqizojë fëmijët me aftësi të kufizuara përmes fëmijëve të Grupit Avokues “Hëna”, dhe t'i nxisë ata për vetë-avokim duke e inkurajuar pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset vendimmarrëse lidhur me çështjet që lidhen me të drejtat e tyre.
- Ky buletin përmbledh aktivitetet të cilat janë realizuar gjatë vitit 2024. Nëpërmjet këtij buletini, fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë pjesë e Grupit Avokues “Hëna” do të inkurajohen të bëhen pjesë e këtij grupi, të vendosin qëllime kuptimplota dhe të punojnë drejt krijimit të një shoqërie më gjithëpërfshirëse.





## RRETH GRUPIT AVOKUESE “HËNA”

- Grupi “HËNA” është grup joformal avokues i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe është formuar në vitin 2017 nga HANDIKOS në bashkëpunim me Save the Children.
- Ky grup, aktualisht përbëhet nga rreth 200 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe aktualisht është aktiv në 7 Komuna të Kosovës- Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Drenas, Mitrovicë dhe Suharekë.





# HëNA



## MISIONI DHE VIZIONI I GRUPIT “HËNA”

- Misioni: Avokim për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.
- Vizioni: Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara trajtohen si qytetarë të barabartë në shoqëri.



# HËNA



## ANGAZHIMI I GRUPIT "HËNA"

- Deri sot, Grupi "Hëna" ka përfaqësuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shumë panele vendore dhe ndërkombëtare, është angazhuar sidomos në fushën e ndërgjegjësimit për aftësinë e kufizuar dhe është përfshirë në të gjitha proceset që ka filluar HANDIKOS, e që prekin të drejtat dhe sfidat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe vetëdijësimit dhe fuqizimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara për mbrojtjen dhe avokimin për realizimin e të drejtave të tyre.





## OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË GRUPIT “HËNA”

- Si qëllim, grupi i ka caktuar vetes respektimin e të drejtave të këtij grupi të veçantë të fëmijëve. Arritja e këtij qëllimi do të bëhet përmes katër objektivave specifike.
  - 1. Rritja e pjesëmarrjes e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën publike.
  - 2. Rritja e përkrahjes së institucioneve qeverisëse për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
  - 3. Ngritja e vetëdijes së shoqërisë lidhur me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
  - 4. Sigurimi i gjithëpërfshirjes në klasa të rregullta për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.









## AKTIVITETET E ORGANIZUARA ME GRUPIN “HËNA” GJATË VITIT 2024

- Bashkë me fëmijët e Grupit “HËNA” janë organizuar shumë aktivitete, duke përfshirë trajnime, punëtori, sesione informimi, fushata sensibilizuese, ndër to trajnime mbi “Mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike”, “Të drejtat e fëmijëve dhe barazia gjinore”, “Vetqëndrueshmëria e Grupit Hëna”, “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”, si dhe takime me përfaqësues të institucioneve në nivel lokal dhe qendror.







## ORGANIZIMI I TRAJNIMIT ME FËMIJËT E GRUPIT HËNA “MBROJTJA E MJEDISIT DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE”

- Objektivi i trajnimit ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive/aftësive në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore, ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe rëndësinë e ndërmarrjes së veprimeve për mbrojtjen e mjedisit.
- Përmes këtij eventi, fëmijët e grupit Hëna patën mundësinë të ngrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre në disa fusha kryesore, si: Kuptimi i ndryshimeve klimatike, Praktikrat e Mbrojtjes së Mjedisit, Avokim dhe Veprim.





## ORGANIZIMI I TRAJNIMIT ME FËMIJËT E GRUPIT HËNA “SI TË SHPREHEMI NË PUBLIK”

- Objektivi kryesor i këtij aktiviteti ishte ngritja e njohurive të fëmijëve të grupit Hëna për rëndësinë e të paraqiturit publik dhe ngritjen e zërit në forma të ndryshme për të drejtat e tyre, duke përdorur edhe mediat. Poashtu fëmijët u informuan edhe për mënyrat se si mund të menaxhohen emocionet dhe stresi në raste të tilla.





## SHËNIMI I DITËS SË TOKËS ME FËMIJËT E GRUPIT HËNA ME MOTON "KUJDESI PËR TOKËN NA LUMTURON"

◆ Për shënimin e kësaj dite, së bashku me fëmijë e prindër të tyre, HANDIKOS mbolli lule të bukura e fidane në kopshtin e qendrës sonë në Prishtinë, aty ku në përditshmëri e frekuentojnë, me qëllim të marrjes së shërbimeve dhe aktiviteteve të ndryshme. Objektivat e këtij aktiviteti "Kujdesi për tokën na lumturon" ishin disa:

- Ndarja e njohurive me fëmijët rreth mjedisit dhe ruajtjes së natyrës duke stimuluar kujdesin ndaj mjedisit;
- Stimulimin e kreativitetit duke përdorur disa lloje të luleve me ngjyra të ndryshme dhe aftësinë për të zgjedhur llojin dhe vendin për mbjelljen e luleve dhe
- Zhvillimin e aftësive sociale- puna në grup





## TAKIME ME PËRFAQËSUES TË INSTITUCIONEVE NË NIVEL LOKAL DHE QENDROR

- Qasja infrastrukturore, si një nga barrierat kyçe nëpër institucionet shkollore, mungesa e asistentëve, planet individuale, terminologjia etj, ishin disa nga temat e ngritura prej fëmijëve në kuadër të takimeve të organizuara.
- Përmes këtyre takimeve ndër të tjera është arritur: Kuptimi i zgjeruar i rolit të institucioneve përkatëse; Krijimi i një raporti ndërmjet grupit Hëna dhe përfaqësuesve të institucioneve përkatëse dhe Ndarje e përvojave dhe sfidave





## SHËNIMI I DITËS SË MJEDISIT ME FËMIJËT E GRUPIT HËNA

- Gjatë këtij aktiviteti janë shpërndarë disa çanta eko-miqësore tek qytetarët, të cilët në të njëjtën kohë janë njoftuar mbi qëllimin dhe rolin e organizimit të këtij aktiviteti nga fëmijët.
- Ky aktivitet pati si objektivë kryesore pëercjelljen e mesazhit për ruajtjen e mjedisit tek qytetarët, së bashku me fëmijët e grupit Hëna. Aftësitë e pjesëmarrëseve të cilat janë synuar për tu përmirësuar gjatë këtij aktiviteti janë: Rritja e vetëdijes mjedisore dhe Kujdesi e dashuria ndaj mjedisit.








## ORGANIZIMI I PUNËTORISË ME FËMIJËT E GRUPIT HËNA “VETQËNDRUESHMËRIA E GRUPIT HËNA”

- Punëtorja e organizuar me fëmijët kishte si qëllim kryesor fuqizimin e tyre dhe nxitjen e vetqëndrueshmërisë. Në këtë kontekst, punëtorja synonte të ofronte një platformë për diskutim dhe shkëmbim ideesh mbi mënyrat se si fëmijët mund të veprojnë dhe të menaxhojnë situatat e tyre pa mbështetje të drejtpërdrejtë.
- Pas punëtorisë u hartua poashtu edhe Manuali i Vetqëndrueshmërisë së Grupit Hëna, qëllimi kryesor i të cilit është ofrojë një kuadër praktik dhe të arritshëm për organizimin e aktiviteteve dhe zbatimin e projekteve të qëndrueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht kur përballen me kufizime financiare ose mbështetje të kufizuar nga donatorët dhe organizatat.







## ORGANIZIMI I TRAJNIMIT ME FËMIJËT E GRUPIT HËNA “OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM”

- Punëtorja e organizuar me fëmijët kishte si qëllim kryesor fuqizimin e tyre dhe nxitjen e vetqëndrueshmërisë. Në këtë kontekst, punëtorja synonte të ofronte një platformë për diskutim dhe shkëmbim ideesh mbi mënyrat se si fëmijët mund të veprojnë dhe të menaxhojnë situatat e tyre pa mbështetje të drejtpërdrejtë.
- Pas punëtorisë u hartua poashtu edhe Manuali i Vetqëndrueshmërisë së Grupit Hëna, qëllimi kryesor i të cilit është ofrojë një kuadër praktik dhe të arritshëm për organizimin e aktiviteteve dhe zbatimin e projekteve të qëndrueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht kur përballen me kufizime financiare ose mbështetje të kufizuar nga donatorët dhe organizatat.






## ORGANIZIMI I TRAJNIMIT ME FËMIJËT E GRUPIT HËNA “TË DREJTAT E FËMIJËVE DHE BARAZIA GJINORE”

- Objektivi kryesor i këtij aktiviteti ishte ngritja e njohurive të fëmijëve të grupit Hëna për Mbrojtjen dhe Pjesëmarrjen e Fëmijëve si dhe për çështjen e barazisë gjinore duke i familjarizuar fëmijët me të drejtat e tyre dhe inkurajuar ata të shprehin mendimet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimet që i prekin ata.
- Poashtu përmes këtij aktiviteti është synuar të ndikohet në edukimin e fëmijëve për rolet dhe stereotipet gjinore, si dhe të nxisë respektin dhe të promovojë mundësi të barabarta.





## ORGANIZIMI I FUSHATËS “RESPEKTOMI TË DREJTAT ”BASHKË ME FËMIJËT E GRUPIT HËNA”

- Qëllimi kryesor i kësaj fushate është të rrisë vetëdijen dhe njohuritë mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të promovojë integrimin e tyre në shoqëri dhe të inkurajojë mbështetje nga komuniteti. Për të arritur këtë, u përzgjedhën mjete të ndryshme që kombinojnë qasjet vizuale, informuese dhe interaktive, duke i bërë mesazhet e fushatës më të kuptueshme, të prekshme dhe të qëndrueshme. Këto mjete përfshijnë broshura edukative, infografika në mediat sociale dhe një angazhim të thelluar me median tradicionale përmes komunikatave dhe mbulimit të eventit.





## Fëmijë të dashur

- Përkushtimi dhe puna e palodhur e juaja deri më tani janë vërtet për t'u admiruar
- Puna juaj përmes avokimit ka ndihmuar në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe ka luajtur një rol kryesor në ndërgjegjësimin për sfidat me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara
- Mezi presim të jemi dëshmitarë të rritjes dhe arritjeve tuaja të vazhdueshme në vitet e ardhshme përmes aktiviteteve të ndryshme që do të realizohen bashkë
- Prandaj Grupi Hëna mirëpret me shumë ngrohtësi edhe fëmijët e tjerë me aftësi të kufizuara që të bëhen pjesë e këtij grupi dhe të shndërrim bashkë drejt arritjes së qëllimeve tona të përbashkëta

